



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti



**Komuna e Prizrenit**  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik**

**KOMUNA E PRIZRENIT**

## **THIRRJE PUBLIKE**

**Mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ në Komunën e Prizrenit  
(duke u bazuar në Rregulloren me nr.- 04/ 2017),**

**Udhëzues për aplikantë**

**Data e hapjes së thirrjes: 24 shkurt 2020**

**Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: 13 mars 2020**

# Përmbajtja

<i>1. MBËSHËTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTET E OJQ-VE, NË FUSHËN E TURIZMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK.....</i>	<i>3</i>
1.1. Problemet të cilat synohet të adresohen përmes kësaj thirrje.....	3
1.2. Objektivat e thirrjes dhe prioritetet për ndarjen e fondeve.....	4
1.3. Vlerat e planifikuara të mbështetjes financiare për projektet dhe totali i thirrjes.....	4
<i>2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES .....</i>	<i>5</i>
2.1. Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikoj? .....	5
2.2. Partnerët e pranueshëm në zbatimin e projektit/programit .....	6
2.3. Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes .....	7
2.4. Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes .....	8
2.4.1. Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme .....	8
2.4.2. Shpenzimet e papranueshme.....	9
<i>3. SI TË APLIKONI? .....</i>	<i>9</i>
3.1. Forma e përshkruese e projektpropozimit .....	9
3.2. Përmbajtja e formës Buxhetit .....	10
3.3. Ku ta dorëzoni aplikimin? .....	10
3.4. Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve .....	10
3.5. Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje? .....	10
<i>4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE .....</i>	<i>11</i>
4.1. Aplikacionet e pranueshme do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:.....	11
4.2. Dokumentacion shtesë dhe Kontraktimi .....	12
<i>5. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES.....</i>	<i>12</i>
<i>6. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE.....</i>	<i>12</i>

# **1. MBËSHTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTET E OJQ-ve, NË FUSHAT E TURIZMIT , TURIZMIT KULTUROR , FUSHAT E ZHVILLIMIT TË TURIZMIT RURAL, FUSHAT E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE ARTIZANAL**

## **1.1 PROBLEMET TË CILAT SYNOHET TË ADRESOHEN PËRMES KËSAJ THIRRJE PUBLIKE**

Me këtë synim Komuna e Prizrenit ofron përkrahje për asociacione dhe shoqatat te cilat veprojnë dhe aktivitetet e tyre i ushtrojnë në fushat e turizmit dhe të zhvillimit ekonomik dhe ofron mbështetjen e tyre me transparencë të plotë dhe pa kurrfarë diskriminimi.

Në këtë vijë Komuna e Prizrenit synon rritjen e llojllojshmërisë së aktiviteteve, tërheqjen e numrit sa më të madh të publikut në këto aktivitete, tërheqjen edhe të turistëve përmes aktiviteteve të krijuara nga ana e OJQ-ve për promovimin e turizmit dhe aktiviteteve të të gjithë qytetarët.

## 1.2 OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE

Objektivi/objektivat e përgjithshme të kësaj Thirrje është që Komuna e Prizrenit ofron përkrahje për OJQ-të dhe asociacionet nga fushat e turizmit dhe zhvillimit ekonomik pa kurrfarë diskriminimi.

Objektivat specifike të kësaj Thirrje janë:

### **Në fushën e turizmit :**

- Promovimi dhe afirmimi i vlerave në fushën e turizmit
- Promovimi i trashëgimisë kulturore;
- Kontribimit në shtrirjen e kalendarit dhe aktiviteteve përgjatë tërë vitit;
- Kontribimit në zhvillimin e turizmit kulturor lokal;

### **Në fushën e zhvillimit ekonomik:**

- Ngritjen e kapaciteteve ekonomike
- Zhvillimi i ndërmarrësisë përmes aktiviteteve të OJQ-ve

Mbështetje financiare publike do të kenë:

Të gjithë OJQ-të dhe asociacionet që aktivitetet e tyre do të zhvillojnë në Komunën e Prizrenit.

## 1.3. KOSTOJA MINIMALE DHE MAKSIMALE E MBËSHTETJES FINANCIARE

Kostoja minimale e mbështetjes së projektit do të jetë me vlerë prej **1.000** euro.  
Kostoja maksimale e mbështetjes së projektit do të jetë me vlerë prej **3.000** euro.

## **1. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES**

### 1.1. Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikoj?

1. Të gjithë OJQ-të, shoqatat, që janë të regjistruara në Ministrinë e Administratës Publike - (për të dëshmuar këtë kërkesë, OJQ-ja aplikuese duhet të dërgoj kopjen e certifikatës së regjistrimit me rastin e aplikimit);
2. Të ketë zotësi juridike, financiare dhe operationale për zbatimin e projektit;
3. OJQ-të, shoqatat të cilët veprimtaria e tyre është e fokusuar në fushën e turizmit dhe zhvillimit ekonomik në Komunën e Prizrenit;
4. Të ketë kryer të gjitha detyrimet tatimore dhe kontributet tjera të detyrueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;
5. Të mos jetë në proces falimentimi, në proces të shuarjes, në procedura të mbledhjes së detyrueshme apo likuidimit;
6. Të gjithë aplikuesit që i kanë përmbyllur projektet paraprake të mbështetura nga Komuna e Prizrenit.

## **2. Nuk kanë të drejtë për të konkurruar sipas kësaj thirrje:**

1. Të gjithë aplikuesit që nuk i kanë përmyllur projektet paraprake të mbështetura nga Komuna e Prizrenit;
2. OJQ-të , e falimentuara;
3. OJQ-të shoqatat të cilat mund të kenë konflikt interesi;
4. Përfaqësuesit e OJQ-së që janë nën hetime;

## **3. Një OJQ/individ mund të paraqesë vetëm një kërkesë, për secilën nga fushat e thirrjes.**

### **1.2. Partnerët e pranueshme në zbatimin e projektit/programit**

1. Një OJQ mund të aplikojë në partneritet me një OJQ tjetër.
2. Partnerët duhet të përmbushin të gjitha kriteret e përshtatshmërisë, si në pikën e specifikuar në pikën 2.1, të këtyre udhëzimeve.
3. Me rastin e aplikimit, OJQ-të duhet të kenë arritur marrëveshje të partneritetit me OJQ-të partnere. **Për këtë qëllim duhet nënshkruar një deklaratë e partneritetit**, e cila duhet të dorëzohet një kopje origjinale të nënshkruar nga secili partner në projekt dhe të ngarkohet përmes aplikacionit online .

### 1.3. Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes:

- Kohëzgjatja e planifikuar e projekteve është nga **qershor 2020** deri në **dhjetor 2020**.
- Aktivitetet e projektit duhet të kryhen **vetëm** brenda territorit të Komunës së Prizrenit.
- Aktivitetet e pranueshme të projektit mund të përfshijnë:

#### **Fushën e turizmit:**

- Promovimin dhe afirmimin e vlerave kulturore.
- Promovimin e trashëgiminë kulturore;
- Shtrirjen e kalendarit kulturor përgjatë tërë vitit;
- Zhvillimin e turizmit lokal
- Zhvillimit rural

#### **Fushën e zhvillimit ekonomik:**

- Ngritjen e kapaciteteve ekonomike;
- Zhvillimi i ndërmarrësisë përmes aktiviteteve.

#### • **Llojet e mëposhtme të aktiviteteve nuk janë të pranueshme për financim:**

- 1 Aktivitete që nuk zhvillohen në Komunën e Prizrenit.
- 2 Aktivitete që përmbajnë çfarëdo diskriminimi i bazuar në ligjin për mbrojtje nga diskriminimi;
- 3 Aktivitete që rrezikojnë mirëqenien e qytetarit;
- 4 Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi ndërmjet aplikuesit dhe organizatës buxhetore (Komuna) – përkatësisht përfaqësuesve / udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

#### 1.4. **Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes**

Përmes fondeve publike të kësaj thirrje publike mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore të specifikuar me këto udhëzime. Në vlerësimin e projektit/programit do të vlerësohen vetëm kostot e nevojave në lidhje me aktivitetet e planifikuara, si dhe në lartësinë reale të këtyre shpenzimeve.

##### 1.4.1. **Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme**

Shpenzimet sipas kostove të pranueshme direkte përfshijnë shpenzimet që janë direkt të lidhura me zbatimin e disa aktiviteteve projektit ose të programit të propozuar, të tilla si:

1. Shpenzimet rreth organizimit i aktiviteteve;
2. Material shpenzues;
3. Skenografia, shpenzimet e zërimit, ndriçimit;
4. Transporti
5. Shpenzimet e komunikimit (shpenzimet e telefonit, internetit),
6. Shërbime grafike (shërbimet për shtypjen e fletushkave, broshurave, revistave, duke specifikuar llojin e qëllimin e shërbimit, sasinë, çmimin e njësisë, etj;)
7. Kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e aktiviteteve të projektit apo programit.



#### 1.4.2. **Shpenzimet e papranueshme:**

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë:

1. Udhëtime;
2. Renovime;
3. Dhurata, shpërblime të ngjashme;
4. Shpenzimet për ushqim dhe pije;

## **2. SI TË APLIKONI?**

Aplikimi i OJQ-ve, shoqatave do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe **dokumentacionin e thirrjes si në vijim:**

1. Formulari i projekt-propozimit;
2. Kopja e Certifikatës së regjistrimit të OJQ-së ,
3. Kopja e Certifikatës së Numrit Fiskal,
4. Dëshmi që nuk ka obligime ndaj ATK-së, (për persona juridik),
5. Dëshmi që ka dorëzuar raportin financiarë nga viti paraprak,
6. Konfirmimin nga banka për xhirrollogarinë e aplikuesit.
7. Formulari i aplikacionit F9
8. Formulari i propozim buxhetit F10
9. Forma e deklaratës për financim te dyfishtë F11
10. Formulari i deklaratës mbi projektet e financuara nga burimet publike te financimit ne vitet e mëparshme F13

Përveç dokumenteve të cekura më lartë dokumentacioni shtesë i cili sipas rregullores mund të kërkohet përmes thirrjes mund të përfshijë:

- Dëshmi e regjistrimit të OJQ-së, **(e obligueshme)**
- Dëshmi e pajisjes me numër fiskal; **(e obligueshme)**
- Dëshmi të fushave të ushtrimit të aktivitetit të OJQ-së,
- Licencë për shërbime të caktuara,
- Dëshmi për menaxhimin financiar transparent,
- Dëshmi për pagesën e taksave dhe kontributeve ndaj shtetit, etj. **(e obligueshme para nënshkrimit të kontratës)**

## 2.1. Aplikacioni i projekt propozimit

Plotësimi i formularit të projekt propozimit (që gjendet në aplikacionin online) është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Ajo përmban të dhëna në lidhje me aplikuesin dhe partnerët si dhe të dhëna mbi përmbajtjen e projektit/programit për të cilin kërkohet financim nga burimet publike.

Në rast se në formën e dorëzuar mungojnë të dhënat në lidhje me përmbajtjen e projektit, aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

## 2.2. Përmbajtja e formës Buxhetit

**Formulari i propozim Buxhetit** është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Propozim Buxheti i dorëzuar duhet të përmbaj informacion për të gjitha shpenzimet direkte të projektit/programit të propozuar për financim.

Nëse forma e buxhetit nuk është e plotësuar në tërësi, nuk do të merret në konsideratë.

## 2.3. Ku ta dorëzoni aplikimin?

Aplikimin mund ta dorëzoni në zyrat e Drejtorisë për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik –Objekti i Beledijes-(Rruga Remzi Ademi), nga ora 08:00 deri në orën 16:00 nga dita e hënë deri të premtën.

Aplikacionet në ndonjë formë tjetër nuk do të pranohen.

## 2.4. Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve

Afati i fundit i thirrjes është data **13 mars 2020** deri në orën **16.00**

## 2.5. Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?

Të gjitha pyetjet në lidhje me thirrjen mund të bëhen vetëm në mënyrë elektronike, duke i dërguar një kërkesë në adresën e mëposhtme: **dtzhepz@gmail.com**, jo më vonë se 5 ditë para skadimit të thirrjes.

### 3. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE

#### 3.1. Aplikacionet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:

- 3.1.1. Komuna e Prizrenit do të themeloj një komision vlerësues të përbërë nga 5 anëtarë nga zyrtar të institucionit dhe ekspert tjerë të jashtëm, i cili ka për detyrë të vlerësoj aplikacionet nëse i plotësojnë kushtet formale të thirrjes publike.
- 3.1.2. Pas kontrollimit të gjitha aplikacioneve të pranuar, komisioni do të përgatis një listë të të gjitha aplikantëve përmes **aplikacionit online**, që i plotësojnë kushtet për tu vlerësuar përmbajtja e projekteve të tyre, dhe një listë të aplikantëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara të konkurrencës.
- 3.1.3. Komuna e Prizrenit do të njoftojë me shkrim të gjithë aplikantët të cilët nuk i plotësojnë kërkesat dhe arsyet e refuzimit të aplikimit të tyre.
- 3.1.4. Në fazën e dytë do të bëhet vlerësimi i përmbajtjes së aplikimeve nga ana e Komisionit vlerësues i përbërë nga 5 anëtarë. Çdo aplikacion i pranuar do të vlerësohet në bazë të formularit të vlerësimit.
- 3.1.5. Lista e përkohshme e projekteve/programeve përfituese të përzgjedhura për financim - Në bazë të vlerësimit të aplikacioneve të cilat i kanë plotësuar kushtet e parashikuara të thirrjes, Komisioni do të hartojë një listë të përkohshëm të projekteve/programeve të përzgjedhura, sipas pikëve që ata kanë marrë në procesin e vlerësimit. Shuma totale e kostos së projekteve të radhitura në listën e përkohshme nuk do të kaloj shumën totale të ofruar për financim përmes thirrjes publike.
- 3.1.6. Krahas listës së përkohshme, bazuar në pikat që janë bërë gjatë vlerësimit, Komisioni do të hartojë edhe listën rezervë të projekteve/programeve.

### **3.2. Dokumentacion shtesë dhe Kontraktimi**

- Për të shmangur shpenzimet e panevojshme shtesë kur të aplikoni, Komuna e Prizrenit do të kërkojë dokumentacion shtesë vetëm nga ata aplikantë të cilët, në bazë të procesit të vlerësimit të aplikacioneve, ka hyrë në listën e përkohshme të projekteve/programeve të përzgjedhura për financim.
- **Njoftimi i aplikuesve** - Të gjithë aplikantët, aplikimet e të cilëve kanë hyrë në procesin e vlerësimit do të jenë të informuar në lidhje me vendimin për ndarjen e projekteve.

## **4. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES**

Fazat e procedurës së thirrjes:

4.1. Afati i fundit për aplikimet **13 mars 2020**.

4.2. Afati i fundit për dërgimin e pyetjeve në lidhje me thirrjen **deri me dt. 28 shkurt 2020**.

## **5. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE**

1. Formulari i projekt-propozimit (merret përmes aplikacionit online);
2. Kopja e Certifikatës së regjistrimit të OJQ-së;
3. Kopja e Certifikatës së Numrit Fiskal;
4. Dëshmi që nuk ka obligime ndaj ATK-së, (për persona juridik),
5. Dëshmi që ka dorëzuar raportin financiar nga viti paraprak,
6. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit.

Deklaratë për mungesën e financimit të dyfishtë

Deklaratë mbi projektet e financuara nga burimet publike